



01-810

Në bazë të nenit 21, 22, 44 dhe 50 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 17, pika d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dt. 20.02.2008, nenit 15 pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr. 110-391, dt. 25.02.2010, si dhe në bazë të kërkesës 05 nr. 351/02-185731/19/1 dt. 22.05.2020, të parashtruar nga Muhamet e Rexhep Mustafa, për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit 05 nr. 351/02-11425/20 dt. 17.08.2020 dhe Vendimit 05 nr. 350/02-0091385/18 dt. 18.07.2018, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 31.05.2021 merr këtë:

## V E N D I M

PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E VENDIMIT 05 NR. 350/02-0091385/18 dt. 18.07.2018

**I. Plotësohet dhe ndryshohet Vendimi 05 nr. 350/02-0091385/18 dt. 18.07.2018**, i lëshuar nga kjo Drejtori, sipas të cilit: *“I Caktohen kushtet ndërtimore pronarëve Muhamet Mustafa dhe Rexhep Mustafa nga Prishtina, sipas kërkesës 05 nr. 351/02-0091385/18 dt. 17.04.2018, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor për ndërtimin ndërtesës bujqësore- për përpunimin e mjedrave, në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal- PZHK, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 517-0 ZK. Rimanishtë”*, e cila parcelë, si rezultat i Vendimit 05 nr. 350/02-0091385/18 dt. 18.07.2018, është formuar parcela kadastrale 517-1 ZK Rimanishtë..

Plotësimi dhe ndryshimi i Vendimit 05 nr. 350/02-0091385/18 dt. 18.07.2018 për caktimin e kushteve ndërtimore, ka të bëjë me zgjerimin e ndërtesës bujqësore me karakter të përkohshëm.

**II. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është “Situacioni”**, me ndryshimet e miratuara me këtë Vendim.

**III. Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit 05 nr. 350/02-0091385/18 dt. 18.07.2018 dhe i njejti prodhon efekte juridike nga dita e lëshimit të këtij Vendimi.**

## A r s y e t i m

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, ka pranuar kërkesën 05 nr. 351/02-185731/19/1 dt. 22.05.2020, të parashtruesve Muhamet dhe Rexhep Mustafa, për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit 05 nr. 350/02-0091385/18 dt. 18.07.2018, me të cilin janë caktuar kushtet ndërtimore të përshkruar si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Bashkë me kërkesë është prezantuar: Dëshmia mbi pronësinë për Njësinë Kadastrale 517-1 dhe kopja e planit ZK. Rimanishtë; Kopje të dokumentit të identifikimit të pronarëve Muhamet e Rexhep Mustafa; Vendim 05 nr. 351/02-16545/19 dt. 26.11.2019 për lejimin e ndërtimit, të lëshuar nga kjo Drejtori; Situacioni me ndryshimet e kërkuara.

Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, Drejtoria e Urbanizmit, bazuar në nenin 13 pika 1.2 të UA të MMPH-së nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, ka vendosur njoftimin publik në lokacion me datë 22.10.2020. Ky njoftim publik, sipas rregullativës ligjore në fuqi, ka qëndruar pesë (5) ditë në lokacionin në fjalë, gjegjësisht deri më datë 26.10.2020 dhe me që ndërkohë kjo Drejtori nuk ka pranuar ndonjë vërejtje apo sugjerim, është vazhduar me procedurën e plotësimit dhe ndryshimit të Vendimit 05 nr. 350/02-0091385/18 dt. 18.07.2018 për caktimin e kushteve ndërtimore.

Drejtoria e Urbanizmit, në vazhdimin e shqyrtimit të kësaj kërkesë, në arkivin e Drejtorisë ka gjetur se, për lokacionin në fjalë, janë lëshuar kushtet ndërtimore me Vendimin 05 nr. 350/02-0091385/18 dt. 18.07.2018, si dhe është lejuar ndërtimi me Vendimin 05 nr. 351/02-16545/19 dt. 26.11.2019.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës 05 nr. 351/02-185731/19/1 dt. 22.05.2020, dokumentacionit të bashkëngjitur, legjislacionit në fuqi, dokumenteve të planifikimit hapësinor dhe të gjeturave në arkivën e Drejtorisë, ka vërtetuar se ndryshimet e kërkuara janë në harmoni me kriteret e përcaktuara me “Rregullore për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizikë dhe Juridik 01 nr. 110-288305 dt. 31.12.2014”, rregullativën ligjore në fuqi, si dhe nuk cenon kushtet dhe kriteret e përcaktuara me dokumentet e planifikimit hapësinorë për lokacionin në fjalë dhe rregullores së sipërpërmendur, andaj, ky Organ, vendosi që përmes këtij Vendimi të bëjë plotësimin dhe ndryshimin, sipas përshkrimit në pikën I të dispozitivit të këtij Vendimi.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Shtojcë: “Situacioni”.**

**Udhëzim juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj Drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo Drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi eporor- MMPHI.

**Ky Vendim u shtyp në 6 (gjashtë) kopje identike fizike dhe i dërgohet:** Kërkuesit/ve; kësaj Drejtorie; në dosje të kësaj lënde; në dosje të lëndës 05 nr. 350/02-0091385/18 dt. 18.07.2018; në dosje të lëndës 05 nr. 351/02-16545/19 dt. 26.11.2019; dhe Qendrës për Shërbim me Qytetarë.

**Kopje elektronike i dërgohet:** Drejtorisë së Kadastrit; dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**05 NR. 351/02-185731/19/1 DT. 31.05.2021**

Zyrtari:  
Arbër Hamidi

u.d. Udhëheqëse e Sektorit:  
Mimoza Berisha Prëstresh

Drejtori:  
Ardian Olluri





SITUACIONI I NGUSHTË

LEGENDA

- Gjelbërini
- Rruga
- Parkingu dhe Levizja Brenda Parcelës
- Halla për Prodhim
- Frigoriferi

- Pisha
- Mali



00517-1

Rruga

Objekti Këmbësor  
Objekti i Frigoriferit